



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
BERAT

Nr. 697 Prot

Berat, më 20/06/2024

Lënda: Kërkesë për caktimin e një anëtari të Komisionit të Pranimit

KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

TIRANË

Në mbështetje të ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr.622, datë 10.2.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, neni 26, Udhëzimit nr.85, datë 11.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, si dhe Vendimit të Këshillit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat nr.318 prot. datë 29.05.2024, “Për ngritjen e Komisionit të Pranimit”, kërkojmë nga ana juaj caktimin e një anëtari në përbërje të këtij komisioni për plotësimin e:

- 1 (një) vendi vakant në pozicionin Sekretar gjyqësor, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat

Komisioni i Pranimit do të jetë si më poshtë:

Kryetar - Eugen Sylari, me detyrë Kancelar

Anëtare - Anduela Guasi, me detyrë Specialiste e Burimeve Njerëzore

Anëtar - një përfaqësues i KLGJ

Vlerësimi me shkrim i kandidatëve do të zhvillohet në datën 25.06.2024 ora 10.30 në ambjentet e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

KANCELAR

EUGEN SYLARI

